



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina



---

**THIRRJE PUBLIKE**

***PËRKRAHJE FINANCIARE PËR PROJEKTET E OJQ-VE PËR  
SHËRBIME SOCIALE***

**Udhëzimet për aplikuesit**

Data e hapjes së thirrjes: **8 prill 2024**

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve: **30 prill 2024**

## **Përmbajtja**

- 1. MBËSHETJE FINANCIARE PËR PROJEKTET E OJQ-VE PËR SHËRBIME SOCIALE .....**
- 1.1 PROBLEMET TË CIALAT SYNOHET TË ADRESOHEN PËRMES KËSAJ THIRRJEJE PUBLIKE .....
- 1.2 OBJEKTIVAT E THIRRJES DHE PRIORITETET PËR NDARJEN E FONDEVE .....
- 1.3 VLERA E PLANIFIKUAR E MBËSHETJES FINANCIARE PËR PROJEKTET DHE TOTAL I THIRRJES .....
2. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES .....
- 2.1. Aplikuesit e pranueshëm: kush mund të aplikojë? .....
- 2.2 Partnerët e pranuesëm në zbatimin e projektit/programit .....
- 2.3 Aktivitetet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes .....
- 2.4 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes .....
- 2.4.1 Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme.....
- 2.4.2 Shpenzimet e papranueshme.....
3. SI TË APLIKONI?.....
- 3.1 Forma përshkruese e projektpropozimit .....
- 3.2 Përmbajtja e formës buxhetit .....
- 3.3 Ku ta dorëzoni aplikimin? .....
- 3.4 Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve.....
- 3.5 Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje? .....
4. VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE .....
- 4.1 Aplikacionet e pranuar do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme:.....
- 4.2 Dokumentacion shtesë dhe kontraktimi.....
5. KALENDARI INDIKATIV I REALIZIMIT TË THIRRJES .....
6. LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE .....

## 1. THIRRJE PUBLIKE PËR SUBVENCIONIM TË SHËRBIMEVE SOCIALE

### 1.1 PROBLEMET TË CILAT SYNOHET TË ADRESOHEN PËRMES KËSAJ THIRRJEJE PUBLIKE

Komuna e Prishtinës, respektivisht Drejtoria E Mirëqenies Sociale e ka përgatitur strategjinë e saj për mirëqenie sociale. Kjo strategji është një tërësi e masave konkrete që për qëllim përfundimtar kanë avancimin e fuqizimin e pjesëtarëve të komuniteteve të njerëzve të marginalizuar, diskriminuar e rrezikuar të shoqërisë sonë. Gjithashtu, nëpërmjet kësaj thirrjeje synohet ofrimi i shërbimeve direkte social për target grupet e strategjisë sonë, të cilat janë:

- Fëmijët /pa përkujdesje prindërore e familjare, në rrezik për humbjen e përkujdesit prindëror;
- Fëmijë të keqtrajtuar, fëmijë dhe të rritur në situatë rruge, të bullizuar (ngacmuar)/stigmatizuar, dhunën në mes bashkëmoshatarëve, të rrezikuar dhe viktima të krimit kibernetik;
- Të gjitha grupimet e personave (fëmijë, të rritur) me aftësi të kufizuara;
- Viktima e krimit, dhunës në familje, trafikimi i qenieve njerëzore dhe krimeve seksuale;
- Të mbijetuarat e dhunës në familje – riintegrimi dhe fuqizimi;
- Prindërit vetushqyes në gjendje të nevojës sociale;
- Vajzat dhe gratë e marginalizuara në aspektin ekonomik dhe social, në viset rurale dhe urbane;
- Fëmijë në forma të rënda të punës;
- Fëmijët me sjellje asociale dhe delikuentet e mitur;
- Të moshuarit në nevojë për përkujdesje familjare e sociale;
- Te miturit në martesat e hershme vajzave dhe djemve – parandalimi dhe vetëdijesimi;
- Komunitetet jo shumicë me përkatësi etnike fuqizimi i kujdesit familjar dhe përfshirja sociale;
- Fëmijët me nevoja të veçanta edukative- arsimore – nevoja logopedike;
- Komuniteti LGBTI+ në nevojë për përkrahje me shërbime profesionale e sociale;
- Abuzuesit e substancave psiko-aktive;
- Familjet në kushte të pafavorshme socio-ekonomike;
- Veteranët dhe invalidët e luftës.

Për secilën prej kategorive të lartpërmendura, thirrja është e dizajnuar asisoj për të implementuar masa konkrete për ndërtimin e infrastrukturës materiale dhe njerëzore të nevojshme. Kjo thirrje në formë të mbështetjes financiare për ofruesit e shërbimeve sociale është përpjekja e radhës për të ofruar mbrojtje dhe shërbime të mirëfillta sociale në nivel lokal, duke përfshirë rritjen e kapaciteteve të strukturave të sigurisë dhe forcimin e bashkëpunimit me autoritetet lokale dhe qendrore për të siguruar mbrojtjen e banorëve brenda këtyre kategorive. Kjo thirrje do krijojë hapësirat e nevojshme përmes së cilave do krijohet mundësia e ofrimit të disa shërbimeve publike, me qëllim që të arrihet një nivel

optimal i ndihmës komunale për pjesëtarët e këtyre komuniteteve shoqërore. Tutje, për të përshpejtuar zhvillimin shoqëror, ofrimin e shërbimeve të drejtpërdrejta sociale, si dhe për të promovuar ndjenjën e përkatësisë komunitare, kjo thirrje për mbështetje financiare do të inkurajojë dhe mbështesë aktivitetet e ndryshme shoqërore që synim përfundimtar e kanë përmirësimin e mirëqenies së përgjithshme sociale. Kjo përfshin organizimin e projekteve të ndryshme në disa grupime, për përmirësimin e cilësisë së jetës komunitare. Këto masa do të ndihmojnë në rritjen e ndërgjegjësimit dhe angazhimit të pjesëtarëve të komunitetit në tërësi, duke krijuar një ambient më të harmonizuar dhe të fortë për të gjithë qytetarët.

## 1.2 OBJEKTIVAT E THIRRJES DHE PRIORITETET PËR NDARJEN E FONDEVE

Objekti/objektivat e përgjithshme të kësaj Thirrje janë:

*Ofrimi i shërbimeve sociale*

Objektivat specifike të kësaj Thirrje janë:

Ofrimi i shërbimeve sociale, grupet e strategjisë për ofrimin e shërbimeve direkte sociale janë:

- Fëmijët /pa përkujdesje prindërore e familjare, në rrezik për humbjen e përkujdesit prindëror;
- Fëmijë të keqtrajtuar, fëmijë dhe të rritur në situatë rruge, të bullizuar (ngacmuar)/stigmatizuar, dhunën në mes bashkëmoshatarëve, të rrezikuar dhe viktima të krimit kibernetik;
- Të gjitha grupimet e personave (fëmijë, të rritur) me aftësi të kufizuara;
- Viktima e krimit, dhunës në familje, trafikimi i qenieve njerëzore dhe krimeve seksuale;
- Të mbijetuarat e dhunës në familje – riintegrimi dhe fuqizimi;
- Prindërit vetëshqyës në gjendje të nevojës sociale;
- Vajzat dhe gratë e marginalizuara në aspektin ekonomik dhe social, në viset rurale dhe urbane;
- Fëmijë në forma të rënda të punës;
- Fëmijët me sjellje asociale dhe delikuentet e mitur;
- Të moshuarit në nevojë për përkujdesje familjare e sociale;
- Të miturit në martesat e hershme, vajzave dhe djemve – parandalimi dhe vetëdijësimi;
- Komunitetet jo shumicë me përkatësi etnike, fuqizimi i kujdesit familjar dhe përfshirja sociale;
- Fëmijët me nevoja të veçanta edukative- arsimore, nevoja logopedike;
- Komuniteti LGBTI+ në nevojë për përkrahje me shërbime profesionale e sociale;
- Abuzuesit e substancave psiko-aktive;
- Familjet në kushte të pafavorshme socio-ekonomike;
- Veteranët dhe invalidët e luftës.

Prioritet për ofrimin e mbështetjes financiare publike do të kenë:

*OJQ që veprojnë në komunën e Prishtinës.*

### 1.3 VLERA PLANIFIKUAR E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR PROJEKTET DHE TOTAL I THIRRJES

1. Për mbështetje financiare publike për projektet/programet sipas kësaj Thirrje publike, është paraparë shuma në dispozicion prej **400,000.00€ (katërqind mijë euro)**.
2. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është **500 € (pesëqind euro)**, ndërsa shuma maksimale për një projekt është **16,000.00 € (gjashtëmbëdhjetë mijë euro)**.

## 2. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES

### 2.1. Aplikuesit e pranueshëm: kush mund të aplikojë?

1. OJQ-të aplikuese të jenë të regjistruara në Ministrinë e Administratës Publike;
2. Të jetë e pajisur me Numër fiskal, të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës;
3. OJQ-të aplikuese duhet të kenë kryer të gjitha detyrimet tatimore ndaj ATK-së;
4. OJQ-ja nuk është në procedurë të shuarjes dhe çregjistrimit;
5. OJQ-ja të mos ketë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete;
6. OJQ-ja nuk do të përfitojë subvencione nga thirrja për mbështetje financiare, në qoftë se ajo ka të nënshkruar një Memorandum bashkëfinancimi me Komunën, në të njëjtin vit kalendarik/buxhetor;
7. Të gjithë aplikuesit që i kanë përmbyllur projektet paraprake të mbështetura nga Komuna e Prishtinës;
8. OJQ-të e licencuara/akredituara nga Ministritë relevante janë të dëshirueshme.

#### 2.1.1 Nuk kanë të drejtë për të konkurruar sipas kësaj thirrjeje:

1. OJQ-të e falimentuara;

2. OJQ-të të cilat kanë dështuar të kryejnë detyrimet tatimore dhe kontributet tjera sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës;
3. OJQ-të të cilat mund të kenë konflikt interesi;
4. Të gjithë aplikuesit që nuk i kanë përmbyllur projektet paraprake të mbështetura nga Komuna e Prishtinës.

Numri i projekteve me të cilat mund të aplikojë një OJQ:

1. Një aplikues mund të paraqesë vetëm një kërkesë për aplikim.

## **2.2 Partnerët e pranueshme në zbatimin e projektit/programit**

Për zbatimin e projektit nuk është e detyrueshme ekzistenca e partneritetit me organizata të tjera, por ai është i dëshirueshëm.

1. Në rast të ekzistencës së partneritetit, partnerët, aplikuesi duhet të veprojnë në partneritet me të paktën (një) OJQ, e cila ushtron aktivitetin në Komunën e Prishtinës ku zbatohet projekti;

Kushtet që duhet t'i plotësojnë partnerët në projekt:

2. Partnerët duhet të përmbushin të gjitha kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për aplikuesit, siç është paraparë në pikën 2.1 të këtyre udhëzimeve.

Raporti në mes të aplikuesit dhe partnerëve:

3. Me rastin e aplikimit, aplikuesi duhet të ketë arritur marrëveshje të partneritetit me OJQ-të partnere. Për këtë qëllim duhet nënshkruar një deklaratë e partneritetit, e cila duhet të dorëzohet në kopje origjinale të nënshkruar nga secili partner në projekt.

## **2.3 Aktivitetet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes**

1. Kohëzgjatja e planifikuar e projekteve është prej 3.6.2024 deri më 3.6.2025;
2. Aktivitete e projektit duhet të kryhen brenda territorit të komunës së Prishtinës;
3. Përfituesit e shërbimeve direkte të financiarë nëpërmjet kësaj thirrjeje, duhet të jenë banorë të komunës së Prishtinës.

Aktivitetet në ofrimin e shërbimeve sociale, OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e mbrojtjes së grupeve të kësaj thirrjeje dhe me target grupet:

- Fëmijët /pa përkujdesje prindërore e familjare, në rrezik për humbjen e përkujdesit prindëror;
- Fëmijë të keqtrajtuar, fëmijë dhe të rritur në situatë rruge, të bullizuar (ngacmuar)/stigmatizuar, dhunën në mes bashkë moshatarëve, të rrezikuar dhe viktima të krimit kibernetik;
- Të gjitha grupimet e personave (fëmijë, të rritur) me aftësi të kufizuara;
- Viktima e krimit, dhunës në familje, trafikimi i qenieve njerëzore dhe krimeve seksuale;
- Të mbijetuarat e dhunës në familje – riintegrimi dhe fuqizimi;
- Prindërit vetushqyese në gjendje të nevojës sociale;
- Vajzat dhe gratë e marginalizuara në aspektin ekonomik dhe social në viset rurale dhe urbane;
- Fëmijë në forma të rënda të punës;
- Fëmijët me sjellje asociale dhe delikuentet e mitur;
- Të moshuarit në nevojë për përkujdesje familjare e sociale;
- Të miturit në martesat e hershme vajzave dhe djemve – parandalimi dhe vetëdijesimi;
- Komunitetet jo shumicë me përkatësi etnike, fuqizimi i kujdesit familjar dhe përfshirja sociale;
- Fëmijët me nevoja të veçanta edukative- arsimore, nevoja logopedike;
- Komuniteti LGBTI+ në nevojë për përkrahje me shërbime profesionale e sociale;
- Abuzuesit e substancave psiko-aktive;
- Familjet në kushte të pafavorshme socio-ekonomike;
- Veteranët dhe invalidët e luftës.

3. Llojet e mëposhtme të aktiviteteve nuk janë të pranueshme për financim:

1. Aktivitetet që nuk zhvillohen në Komunën e Prishtinës;
2. Aktivitetet që përmbajnë diskriminim gjinor, racor dhe fetar.

## 2.4 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes

Përmes fondeve publike të kësaj thirrjeje publike mund të financohen vetëm kostot reale dhe të pranueshme për realizimin e aktiviteteve të projektit, në periudhën kohore të specifikuar me këto udhëzime. Në vlerësimin e projektit/programit, do të vlerësohen vetëm kostot e nevojave në lidhje me aktivitetet e planifikuara, si dhe në lartësinë reale të këtyre shpenzimeve.

### 2.4.1 Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme

Shpenzimet sipas kostove të pranueshme direkte, përfshijnë shpenzimet që janë direkt të lidhura me zbatimin e disa aktiviteteve, projektit ose të programit të propozuar, të tilla si:

1. Organizimi i aktiviteteve që ofrojnë mbështetje për personat e moshuar, fëmijët, viktimat e dhunës në familje, trafikimit, ofrimi i shërbimeve ditore terapeutike, fuqizimi dhe zhvillimi profesional, ofrimi i strehimit dhe mbrojtja e të drejtave të grave dhe të rinjve, trajtimi dhe përkujdesi për të moshuarit, komunitetin LGBT, minoritetet etnike dhe abuzuesit me substanca narkotike.
2. Shpenzimet e furnizimit me ushqime dhe medikamente për persona që janë të strehuar dhe marrin shërbime të ndryshme social edhe familjare;
3. Shpenzimet e furnizimit me material higjienik për nevoja të personave që marrin shërbime nga projekti;
4. Shpenzimet e stafit menaxhues dhe profesional të angazhuar në zbatimin e aktiviteteve të projektit, duke u bazuar në llojin e shërbimeve që ofrojnë dhe kohën e ndarë për zbatimin e aktiviteteve për projektin;
5. Shpenzimet e pagave dhe pagesave për menaxherët e projektit/programit, të kontraktorëve të projektit nga organizatat dhe partnerët e përfshirë në projekt, duke specifikuar kategoritë e profesionistët të angazhuar, numrin e muajve të angazhimit dhe shumën mujore bruto të kompensimit;
6. Shpenzimet e qirasë për zhvillimin e aktiviteteve dhe ofrimit të shërbimeve në lokalet relevante;
7. Shpenzimet e komunikimit (shpenzimet e telefonit, internetit etj.);
8. Shpenzimet edukative dhe të aftësimit profesional për kategoritë përfituese që janë pjesë e projektit;
9. Shpenzimet e organizimit të aktiviteteve dhe këshillime psiko-sociale për kategoritë përfituese që janë pjesë e projektit;
10. Shpenzimet e transportit dhe derivateve, të cilat janë të planifikuara për qëllim të ngrohjeve apo vizitave në terren dhe familje;
11. Shpenzimet e komunaleve (ujë, mbeturinat, energjia elektrike dhe ngrohje) dhe mirëmbajtjes, për projektet të cilat zhvillojnë aktivitete të qëndrimit rezidencial apo ditor.

#### **2.4.2 Shpenzimet e papranueshme**

Shpenzimet e papranueshme përfshijnë:



1. Kostot që nuk mbulohen nga marrëveshja (kontrata me ofruesin e mbështetjes financiare);
2. Shpenzimet e interesit për borxhin dhe kamatat;
3. Investimet në kapital apo kredi për investime, fonde të garancisë;
4. Gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet e procedurave gjyqësore;
5. Pagesa e bonuse për punonjësit;
6. Kostot e tjera që nuk janë të lidhura direkt me përmbajtjen dhe objektivat e projektit.

### **3. SI TË APLIKONI?**

*Aplikimi i OJQ-ve do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes, si në vijim:*

1. Formulari i projekt-propozimit;
2. Formulari i propozim-buxhetit ;
3. Formulari i deklaratës së partneritetit;
4. Kopja e Certifikatës së regjistrimit të OJQ-së;
5. Kopja e Certifikatës së Numrit fiskal;
6. Forma e deklaratës të mungesës së financimit të dyfishtë (OJQ-ja aplikuese nuk duhet të ketë pranuar mjete financiare për realizimin e të njëjtave aktivitete në vitin përkatës fiskal;
7. Forma e deklarimit të projekteve apo programeve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike të financimit;
8. Certifikatë nga Administrata Tatimore e Kosovës në lidhje me gjendjen e borxhit publik, OJQ-të aplikuese duhet të kenë kryer të gjitha detyrimet tatimore ndaj ATK-së. Ndonëse mund të ketë detyrime të pashlyera në momentin e aplikimit, OJQ-ja që përfiton nga fondet publike para nënshkrimit të kontratës, duhet të dëshmojë se ose ka kryer obligimet tatimore ose ka arritur ndonjë marrëveshje me ATK-në për kryerjen e tyre në të ardhmen. Ekzistenca e borxheve dhe obligimeve tjera të pashlyera nuk guxon të ndikojë në implementimin e projektit, prandaj, zgjidhja e çfarëdo detyrimi të tillë para nënshkrimit të kontratës është e domosdoshme;
9. Dëshmi nga aplikuesi se nuk është nën falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata Themelore – kërkohet origjinali jo më i vjetër se 30 ditë;
10. Dëshminë e xhirollogarisë aktive të aplikuesit në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovë;
11. Kopjen e letërnjoftimit të personit/ve në emër të cilit/ëve është i regjistruar aplikuesi;
12. Të dorëzojë të dhëna për personelin kyç, duke specifikuar detyrat e tyre, siguruar CV-të e tyre së bashku me një deklaratë pranimit nga ana e tyre se do të punojnë për projektin/programin;
13. Të sigurojnë dëshmitë e duhura për projektet për të cilat kërkohet bashkëfinancim;
14. Të dëshmojnë se kanë përvojë në realizimin e projekteve/programeve të ngjashme, duke siguruar dëshmi të realizimit të projekteve të ngjashme në të kaluarën;

15. Të paraqesin leje/licencë për ushtrimin e veprimtarisë, në rastet kur me legjislacionin në fuqi ushtrimi i një veprimtarie të tillë mund të kryhet vetëm me leje/licencë nga autoritetet publike.

***Dorëzimi i aplikacioneve bëhet në zarfë të mbyllur, ku brenda zarfit vendoset një kopje e printuar e të gjithë dokumentacionit origjinal të kërkuar, si dhe një kopje elektronike në CD. Forma është e nevojshme të plotësohet me kompjuter. Nëse forma është plotësuar me dorë nuk do të merren në konsideratë.***

### **3.1 Aplikacioni i projekt-propozimit**

Plotësimi i formularit të projektpropozimit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Ajo përmban të dhëna në lidhje me aplikusin dhe partnerët, si dhe të dhëna mbi përmbajtjen e projektit/programit për të cilin kërkohet financim nga burimet publike.

Në rast se në formën e dorëzuar mungojnë të dhënat në lidhje me përmbajtjen e projektit, aplikimi nuk do të merret në konsideratë.

Forma është e nevojshme të plotësohet me kompjuter. Nëse forma është plotësuar me dorë nuk do të merren në konsideratë.

Nëse forma përshkruese përmban të meta si më sipër, aplikimi do të konsiderohet i pavlefshëm.

### **3.2 Përmbajtja e formës, buxhetit**

Formulari i propozimuxhetit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Propozim-buxheti i dorëzuar duhet të përmbajë informacion për të gjitha shpenzimet direkte dhe indirekte të projektit/programit të propozuar për financim.

Nëse forma e buxhetit nuk është e plotësuar në tërësi, apo nuk është dorëzuar në formën përkatëse, aplikimi nuk do të merret në konsideratë.

Forma është e nevojshme të plotësohet me kompjuter. Nëse forma është plotësuar me dorë nuk do të merret në konsideratë.

### 3.3 Dorëzimi i aplikacionit

Format e detyrueshme dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të dërgohen në formë fizike, të shtypur (një origjinal) dhe në formë elektronike (në CD). Format e detyrueshme duhet të jenë të nënshkruara nga përfaqësuesi i autorizuar dhe të vulosura me vulën zyrtare të organizatës. Dokumentacioni në formë elektronike (në CD) duhet të ketë të njëjtën përmbajtje, pra të jetë identik me versionin e shtypur. Dokumentacioni i shtypur dhe ai elektronik në CD, duhet të vendosen në një zarf të mbyllur.

Aplikimi origjinal duhet të dërgohet me postë ose në person (dhe të dorëzohet në Zyrën përkatëse). Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet emri i thirrjes publike, së bashku me emrin e plotë dhe adresën e aplikuesit dhe shënimin *"Të mos hapet para takimit të Komisionit vlerësues"*.

Aplikacionet duhet të dërgohen në adresën e mëposhtme:

<p><i>Komuna e Prishtinës</i> <i>Drejtoria e Mirëqenies Sociale</i> <i>Rr. UCK, nr 2, 10000, Prishtinë</i> <i>Qendra për shërbime me qytetarë</i> <i>Kati përdhes, sporteli nr. 3</i> <i>"Të mos hapet para mbledhjes së Komisionit vlerësues"</i></p>
--

### 3.4 Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve

Afati i thirrjes është 15 ditë pune nga data e hapjes së thirrjes dhe zgjatë deri më **30 prill 2024**, deri në orën 15:00.

Aplikacioni i dorëzuar brenda periudhës së thirrjes pranohet nëse vula pranuese tregon se është dorëzuar në postë deri në fund të datës së thirrjes, si afati i fundit për dorëzim.

Aplikacionet e dërguara pas afatit të paraparë, nuk do të merren parasysh.

### 3.5 Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?

Të gjitha pyetjet në lidhje me thirrjen mund të bëhen vetëm në mënyrë elektronike, duke i dërguar një kërkesë në adresën e mëposhtme: [premtim.fazliu@rks-gov.net](mailto:premtim.fazliu@rks-gov.net) dhe [munavere.qerkezi@rks-gov.net](mailto:munavere.qerkezi@rks-gov.net), jo më vonë se 8 ditë para skadimit të thirrjes.

## 4. VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE

### 8.1 Aplikacionet e pranuar do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme:

4.1.1 Komuna e Prishtinës do të themelojë një komision vlerësues, të përbërë nga 5 anëtarë nga zyrtarë të institucionit dhe ekspertë të tjerë të jashtëm, i cili ka për detyrë të vlerësojë aplikacionet nëse i plotësojnë kushtet formale të thirrjes publike.

Pas kontrollimit të të gjitha aplikacioneve të pranuar, komisioni do të përgatisë një listë të të gjithë aplikuesve që i plotësojnë kushtet për t'u vlerësuar përmbajtja e projekteve të tyre, dhe një listë të aplikuesve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara të konkurrencës.

Komuna e Prishtinës do të njoftojë me shkrim të gjithë aplikuesit të cilët nuk i plotësojnë kërkesat dhe arsyet e refuzimit të aplikimit të tyre.

4.1.2 Në fazën e dytë, do të bëhet vlerësimi i përmbajtjes së aplikimeve nga ana e Komisionit vlerësues, i përbërë nga 5 anëtarë. Çdo aplikacion i pranuar do të vlerësohet në bazë të formularit të vlerësimit.

Lista e përkohshme e projekteve/programeve të përzgjedhura për financim - Në bazë të vlerësimit të aplikacioneve, të cilat i kanë plotësuar kushtet e parashikuara të thirrjes, Komisioni do të hartojë një listë të përkohshme të projekteve/programeve të përzgjedhura, sipas pikëve që ata kanë marrë në procesin e vlerësimit. Shuma e përgjithshme e kostos së projekteve të radhitura në listën e përkohshme, nuk do të kalojë shumën e përgjithshme të ofruar për financim përmes thirrjes publike.

Krahas listës së përkohshme, bazuar në pikat që janë bërë gjatë vlerësimit, Komisioni do të hartojë listën rezervë të projekteve/programeve.

## 4.2 Dokumentacioni shtesë dhe Kontraktimi

Për të shmangur shpenzimet e panevojshme shtesë kur të aplikoni për konkurrencën, Komuna e Prishtinës do të kërkojë dokumentacion shtesë vetëm nga ata aplikues të cilët, në bazë të procesit të vlerësimit të aplikacioneve, ka hyrë në listën e përkohshme të projekteve/programeve të përzgjedhura për financim.

Komisioni vlerësues do të bëjë kontrollimin e dokumentacionit shtesë.

Nëse aplikuesi nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar shtesë brenda kohës *10 ditë*, aplikimi do të refuzohet.

Pas kontrollit të dokumentacionit të paraqitur, Komisioni do të propozojë listën përfundimtare të projekteve/programeve të përzgjedhura për financim.

**Njoftimi i aplikuesve** - Të gjithë aplikuesit aplikimet e të cilëve kanë hyrë në procesin e vlerësimit, do të jenë të informuar në lidhje me vendimin për ndarjen e projekteve/programeve në kuadër të thirrjes.

## 9. KALENDARI INDIKATIV I REALIZIMIT TË THIRRJES

Fazat e procedurës së thirrjes

1. Afati i fundit për aplikimet (**30.4.2024**);
2. Afati i fundit për dërgimin e pyetjeve në lidhje me thirrjen (**22.4.2024**).

Financuesi ka të drejtë të përditësojë kalendarin indikativ. Duhet të dini se çdo ndryshim në kalendarin indikativ, do të publikohet në faqen e internetit : <https://prishtinaonline.com/drejtore/mireqenia-sociale/subvencionet>

## 10. LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE

FORMULARËT

*Listo të gjithë formularët e nevojshëm të paraparë sipas Rregullores dhe Manualit për implementimin e saj, p.sh.:*

1. *Formulari i Aplikacionit për projekt/programit (formulari të shkarkohet nga linku);*
2. *Formulari i Propozim-buxhetit (formulari të shkarkohet nga linku);*
3. *Formulari i Deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë (formulari të shkarkohet nga linku);*
4. *Formulari i Raportit Financiar (formulari të shkarkohet nga linku);*
5. *Formulari i Raportit narrativ-përshkrues (formulari të shkarkohet nga linku);*
6. *Formulari i Deklaratës së projekteve te financuara (formulari të shkarkohet nga linku);*
7. *Formulari i Deklaratës së partneritetit (formulari të shkarkohet nga linku).*